

# Buletini 18

Janar – Qershor 2023



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



## Prezantimi i Buletinit të 18<sup>të</sup> të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Përgjatë periudhës gjashtë mujore, janar – qershor 2023, Rregullatori i Energjisë është përpjekur që aktivitetet t'i zhvilloi në përputhje me obligimet ligjore dhe me planin e performancës.

Gjatë kësaj periudhe Bordi i ZRRE ka mbajtur pesë (5) seanca publike ku ka shqyrtuar dhe marrë shtatëdhjetë e gjashtë (76) vendime.

Vendimet e Bordit janë të prezantuara në këtë buletin, e poashtu janë të publikuara në faqen elektronike të Rregullatorit

Në këtë buletin po ashtu janë paraqitur të dhënat mbi licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë si dhe të dhëna për autorizimet për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe për vetë-konsum.

Po ashtu, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në sektorin e energjisë dhe rritjes së efikasitetit, ZRRE në vazhdimësi monitoron performancën e operatorëve dhe shqyrton ankesat e konsumatorëve. Gjatë periudhës janar – qershor 2023, ZRRE ka zgjidhur njëqind e një (101) ankesa të konsumatorëve.

Ndër aktivitetet e tjera, Rregullatori i përfaqësuar nga personeli i tij ka ndjekur edhe aktivitete ndërkombëtare që janë organizuar për sektorin, sidomos ngjarjet e organizuara nga Komuniteti i Energjisë, Asociacionet e Rregullatorëve (ERRA, NARUC, CEER) si dhe aktivitetet të tjera ku ZRRE është e përfshirë.

## Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike

Në seancën e parë të vitit 2023, e cila është mbajtur më 27.01.2023, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka miratuar Bilancin Vjetor të Energjisë Elektrike për 2023. Qëllimi kryesor i miratimit të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike është që të projektojë përmbushjen e nevojave të konsumatorëve me energji elektrike, në sasi të mjaftueshme gjatë vitit, duke angazhuar kapacitetet e prodhimit dhe importit të energjisë elektrike.



*Seanca e parë e Bordit të ZRRE-së*

Po ashtu në këtë seancë, Bordi ka shqyrtuar komentet nga gjeneratori publik KEK lidhur me monitorimin e shit-blerjes së energjisë elektrike, si dhe komentet nga KOSTT lidhur me monitorimin e blerjeve të energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për operatorin e sistemit të transmetimit (KOSTT).

### Takim Publik për Rregullën për Prosumatorët me Burime të Ripërtërithme të Energjisë (Rregulla për Prosumatorë)

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më 23 shkurt 2023 ka mbajtur një takim publik me akterët e sektorit të energjisë, zhvilluesit, bankat, shoqatat e biznesit, odat ekonomike dhe organizatat ndërkombëtare të zhvillimit për të shqyrtuar draft-Rregullën për Prosumatorët me Burime të Ripërtërithme të Energjisë (Rregulla për Prosumatorë).

Draft Rregulla për Prosumatorët me Burime të Ripërtërithme të Energjisë (BRE) është hartuar për të promovuar zhvillimin e energjisë së ripërtërithme dhe për të rritur sigurinë e furnizimit në Kosovë. Kjo rregull ka për qëllim të sigurojë çmime të përbalueshme të energjisë elektrike, duke ofruar gjithashtu përfitime mjedisore, sociale dhe shëndetësore, si dhe të lehtësojë rritjen e biznesit dhe mundësitë e punësimit.

Konsumatorët tani do të kenë një bazë ligjore të përcaktuar për të gjeneruar energjinë e tyre dhe mund të përfitojnë si nga kursimet e kostos nga vetë-prodhimi ashtu edhe nga injektimi në rrjet i energjisë së tepërt të prodhuar por që nuk përdoret nga ta.



*Prezantimi i Draft- Rregullës për Prosumatorët*

Rregulla e re për prosumatorët lejon të gjitha kategoritë e konsumatorëve të marrin pjesë aktive në sektorin e energjisë duke prodhuar vetë energji elektrike nga gjeneratorët e tyre. Kjo rregull në mënyrë indirekte do të ndihmojë në uljen e kërkesës së përgjithshme për energji elektrike në mbarë Kosovën, duke reduktuar nevojën për nivele më të larta të importeve të shtrenjta të energjisë,” shpjegoi Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së.

Rritja e numrit të prosumatorëve do të thotë një rritje në pjesën e prodhimit të energjisë së ripërtërithme duke mbështetur kështu edhe procesin e dekarbonizimit.

Për më tepër, draft-Rregulla për Prosumatorët e ndërlidhur me Ligjin në pritje për Burimet e Ripërtërithme të Energjisë (Ligji i BRE) do të konsolidojë më tej legjislacionin e Kosovës për energjinë dhe do të ofrojë më shumë qartësi dhe besim për investitorët dhe bizneset që realizojnë vetë-gjenerim me burime të ripërtërithme dhe palët tjera të interesit.

### Takim me përfaqësues nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE)

Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji z. Ymer Fejzullahu ka pritur në takim drejtorin e Sekretariatit të Energjisë Artur Lorkowski dhe zv.drejtorin Dirk Buschle

Në këtë takim, Kryesuesi i Bordit e ka njoftuar drejtorin Lorkowski për situatën e përgjithshme në sektorin e energjisë si dhe angazhimet e ZRRE-së në funksion të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për të gjithë qytetarët e vendit.

Z. Lorkowski në këtë takim shprehu gatishmërinë e Sekretariatit në ofrimin e asistencës së nevojshme për ZRRE-në për të siguruar zhvillimin e një sektori të besueshëm dhe të qëndrueshëm me energji.



*Mars 2023, Gjatë takimit me përfaqësues të SKE-së*

### Takim me përfaqësues të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW)

Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji z. Ymer Fejzullahu i shoqëruar nga anëtarë të Bordit dhe Drejtori Menaxhues kanë prituri në takim përfaqësuesit e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) me qëllim të informimit në lidhje me bazën rregullative të efikasitetit të energjisë.

Kryesuesi i Bordit z. Fejzullahu, ka informuar të pranishmit me zhvillimet e fundit të kornizës rregullatore sa i përket Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë dhe ka potencuar rëndësinë e madhe të mbështetjes së donatorëve dhe në veçanti ndihmën e KfW dhënë për sektorin e energjisë.



*Mars 2023, Gjate takimit me përfaqësues të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW)*

### Takim në mes Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës

Ky takim kishte për qëllim informimin e Asociacionit të Komunave me situatën në sektorin e energjisë elektrike me fokus të veçantë në planet zhvillimore të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe gjetjen e mundësive të reja të bashkëpunimit midis Rregullatorit dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, duke pasur si prioritet sigurinë e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve dhe përmirësimin e standardeve të shërbimit për konsumatorë përmes shtimit të investimeve në rrjetin e shpërndarjes.



*Mars 2023, Takimi i Bordit të Rregullatorit me Bordin e Asociacionit të Komunave*

Në takim u theksua se ZRRE-ja është institucioni i vetëm përgjegjës që ka autoritet ligjor për miratimin e Planeve Zhvillimore për të gjitha veprimtaritë e rregulluara që kryhen nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

Me interes të posaçëm u trajtua edhe çështja e nevojës për dislokim të aseteve energjetike me kërkesë të komunave dhe parashikimit të investimeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën e ardhshme 5 dhe 10 vjeçare. Nga ana e ZRRE-së u theksua se në kuadër të këtij procesi janë trajtuar me kujdes të gjitha investimet e propozuara nga KEDS, që kanë për qëllim zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë së shërbimit.

### Takim në mes Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Me datë 13 mars 2023 është mbajtur takim mes Bordit Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Takimi kishte për qëllim njohjen e Misionit të FMN-së me situatën në sektorin e energjisë elektrike si dhe me mënyrën e vlerësimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale për të licencuarit e rregulluar për vitin 2023.

Nga ana e ZRRE-së u bë një prezantim i hollësishëm i situatës elektro-energetike në vend, duke paraqitur të dhëna krahasuese ndër vite lidhur me prodhimin, importin si dhe të treguesve të humbjeve të energjisë elektrike. Gjithashtu, u bë edhe një analizë krahasuese e çmimeve të energjisë elektrike.

Në vazhdim, përfaqësuesit e ZRRE-së dhanë shpjegime të hollësishme, deri në detaje, mbi metodologjinë dhe të dhënat e përdorura për vlerësimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin 2023.



*Mars 2023, Takimi i Bordit të Rregullatorit me përfaqësues të FMN-së*

Nga ana e përfaqësuesve të FMN-së ky takim u vlerësua shumë i dobishëm, pasi që do të ndikoj në pikëpamjet dhe vlerësimet e Misionit të FMN-së për ecurinë e mëtejshme të sektorit të energjisë elektrike.

Si përfundim, Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së theksoi se mbetet i hapur për të analizuar me përgjegjësi çdo propozim i cili mund të sjell ndikim të ndjeshëm në sektorin e energjisë dhe shprehu përkushtimin dhe gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm me FMN-në.

### Takim me përfaqësues të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Më 20 mars 2023, në ambientet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, u zhvillua një takim midis Kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji z. Ymer Fejzullahu i shoqëruar nga anëtarët e Bordit dhe drejtori menaxhues dhe shefit të Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD-së) për Kosovë z. Sergiy Masclichenko me bashkëpunëtor.

Takimi kishte për qëllim njohjen me situatën në Sektorin e Energjisë Elektrike si dhe me perspektiven në zhvillimin e projekteve të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Nga ana e ZRRE-së u bë një prezantim i hollësishëm i kornizës ligjore në vend, duke paraqitur edhe synimet e vendosura në Strategjinë e Energjisë për sa i përket zhvillimit të BRE-ve.

Duke vlerësuar lartë bashkëpunimin ndër vite, u theksua përkushtimi i përbashkët për zhvillimin dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të partneritetit me EBRD në procese të rëndësishme për zhvillimin e sektorit, me theks të veçantë në projektet e infrastrukturës së KOSTT dhe KEDS që kanë të bëjnë me integrimin e BRE-ve



*20 Mars 2023, Takimi i Bordit të Rregullatorit me përfaqësues të EBRD-së*



### Seanca e dytë e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Më 23 mars 2023, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur seancën e tij të dytë (II).

Në këtë seancë është marrë vendim që të i vazhdohet operatorit të Furnizimit KESCO, Obligimi për Furnizim me Shërbim Universal të konsumatorëve deri më 31 mars 2024. Vendimi për vënien e këtij obligimi është marrë në bazë të obligimeve ligjore të Ligjit për Rregullatorin për Energji, Ligjit për Energjinë Elektrike, Rregullës për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal, si dhe obligimet që rrjedhin nga kriteret për vlerësimin e konkurrencës në furnizim me energji elektrike ku përfshihen edhe rezultatet e indeksit për matjen e konkurrencës "Herfindahl Hirschman".

Gjithashtu, Bordi ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për operatorët e rregulluar për periudhën e tretë rregullative 2023-2027 për: Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut/KOSTT; Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes/KEDS dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal FSHU për vitin 2023.

Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal FSHU/KESCO janë aprovuar në vlerë prej 398.44 mil€, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut/KOSTT janë aprovuar në vlerë prej 59.69 mil€ dhe për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes/KEDS janë aprovuar në vlerë prej 133.81 mil€.

Me aprovimin e këtyre të hyrave, ZRRE, ndër të tjera, ka marrë në konsideratë edhe rritjen e çmimeve të importit të cilat janë jashtë kontrollit të operatorëve si dhe subvencionin që është alokuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, rritja e të hyrave do të reflektoj në ngritje të çmimeve të energjisë elektrike rreth 15% për konsumatorët fundor në vitin tarifor, të cilat do të hyjnë në fuqi prej 1 prill 2023 deri më 31 mars 2024.

Në këtë seancë janë shqyrtuar dhe miratuar Planet Zhvillimore dhjetë (10) vjeçare dhe Planet Zhvillimore Investive pesë (5) vjeçare për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, bilancet e energjisë termike si dhe janë shqyrtuar dhe aprovuar tetëmbëdhjetë (18) kërkesa të konsumatorëve për autorizim për vetë-konsum, nga të cilat njëmbëdhjetë (11) vijnë nga ndërmarrjet dhe shtatë (7) nga personat fizik me gjithsej 605kW.



23 Mars 2023, Seanca e dytë e Bordit të Rregullatorit

### Seanca e Tretë e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Më 30 mars 2023, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka mbajtur seancën e tij të tretë (III) për vitin 2023, ku ka aprovuar tarifën e energjisë elektrike për shërbime të rregulluara në sektorin e energjisë, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë të aprovuara do të jenë në masën 15.4% më të larta për çdo kategori të konsumatorëve të rregulluar. Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e kostove të furnizimit janë:

- Rritja e çmimeve të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare. Edhe pse në vitin 2023 çmimet e energjisë elektrike në tregjet evropiane shënuan rënie në krahasim me vitin 2022, ato vazhdojnë të jenë më të larta në krahasim me çmimet që mbulojnë tarifën aktuale.
- Kapacitetet e kufizuara gjeneruese në vend për të plotësuar kërkesën në rritje detyrojnë Kosovën të blejë sasi më të mëdha të energjisë elektrike në tregun rajonal dhe ndërkombëtar.
- Shkalla shumë e lartë e inflacionit, nga 0.25% deri në 1.75% në periudhën 2018 deri 2020, në 8.39% në vitin 2022, ndikoi në rritjen e konsiderueshme të kostove tek furnizuesit e energjisë elektrike.

ZRRE-ja njofton të gjithë konsumatorët se çmimet e reja të energjisë do të aplikohen për sasinë e energjisë të konsumuar nga data **1 Prill 2023**.



*30 Mars 2023, Seanca e tretë e Bordit të Rregullatorit*

Vlen të theksohet se gjatë përcaktimit të tarifave bëhet reflektimi i kostove të shërbimit për secilin aktivitet të sektorit të energjisë elektrike kështu që garantohet siguria dhe vazhdueshmëria e furnizimit me energji elektrike.

Tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, për konsumatorët e rregulluar të aprovuara reflektojnë koston e shërbimit për secilin aktivitet ashtu që të mos cenohet siguria dhe vazhdueshmëria e furnizimit me energji elektrike. Tarifa e aprovuara duhet të mbulojnë kostot investive të nevojshme në termocentrale, investimet në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, reflektimin e kostove me shumicë të blerjes së energjisë elektrike dhe të operimit. Bordi i ZRRE-së në këtë seancë ka aprovuar edhe tarifën për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe tarifën për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit dhe Operimit të Tregut.

## Buletini 18


Në seancën e Bordit u vendos që tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë të jenë në masën 15.4% më të larta për çdo kategori të konsumatorëve të rregulluar të energjisë elektrike.

Me qëllim të informimit të saktë të konsumatorëve, Zyra e Rregullatorit për Energji ka dalur me një krahasim të faturave të konsumit mujor për konsumatorët familjar me tarifa paraprake dhe me tarifa të reja, të cilat janë ilustruar në tabelën në vijim.

Krahasimi i faturave sipas tarifave të reja me ato të vitit 2022

Llogaritja e faturës së energjisë elektrike për konsumatorët familjarë						
Konsumatori	A	B	C	D	E	F
Konsumi mujor	300kWh	450kWh	600kWh	800kWh	1000kWh	1200kWh
Kalkulimi me tarifat paraprake	€ 18.75	€ 27.18	€ 35.62	€ 46.86	€ 68.18	€ 89.51
Kalkulimi me tarifat e reja	€ 21.63	€ 31.36	€ 41.10	€ 54.09	€ 78.70	€ 103.31
Ndryshimi (rritja)	€ 2.88	€ 4.18	€ 5.49	€ 7.23	€ 10.51	€ 13.80

*Shënim: Llogaritjet e faturave janë bazuar në raportin e konsumit - Tarifa e lartë 60% dhe Tarifa e ultë 40%*



### Seanca e Katërt e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Më 5 maj 2023 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, ka mbajtur seancën e tij të IV-të me radhe për 2023. Në këtë seancë janë aprovuar kërkesat për vazhdimin e Licencës për furnizim me energji elektrike të ndërmarrjes Future Energy Trading and Exchange Dynamics dhe licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike të ndërmarrjes Danske Commodities Kosova sh.p.k, si dhe është miratuar kërkesa për dhënie të licencës për furnizim me energji elektrike të ndërmarrjes Sharrcem.

Në këtë seancë, pas shqyrtimit përfundimtar të raporteve të monitorimit për shkak të shkeljeve ligjore të konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet, Bordi ka vendosur gjobë ne vlerën prej 3.2 milion euro për Korporatën Energjetike të Kosovës dhe 439.000 euro për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT).



*30 Mars 2023, Seanca e katërt e Bordit të Rregullatorit*

Po ashtu në këtë seancë, Bordi ka shqyrtuar dhe miratuar propozimin për korrigjimin e vendimeve V\_1680\_2023 dhe V\_1681\_2023 lidhur me kontestin e ngritur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO).

Në këtë seancë, Bordi ka shqyrtuar dhe miratuar pesëmbëdhjetë (15) kërkesa të konsumatorëve për autorizim për vetë-konsum nga të cilat katër (4) vijnë nga ndërmarrjet dhe njëmbëdhjetë (11) nga personat fizik me gjithsej 268 kW.

### Takim me përfaqësues të NARUC lidhur me bashkimin e tregjeve të energjisë

Në kuadër të iniciativës së USAID-it për Bashkimin e Tregjeve të Evropës Juglindore, me datë 12.05.2023, Bordi i ZRRE-së ka pritur në takim përfaqësuesit e NARUC-it në punëtorinë ku u diskutuan hapat e nevojshëm për zhvillimin e tregut.

Këshilltarët teknik të NARUC-it janë duke mbështetur rregullatorët e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për bashkimin e tregjeve të këtyre tri vendeve që kanë për synim rritjen e efikasitetit të përgjithshëm të tregtimit duke nxitur konkurrencën efektive, rritur likuiditetin dhe duke mundësuar përdorimin më efikas të burimeve të gjenerimit dhe kapacitetit ndërkufitar.



*Gjatë takimit me përfaqësues të NARUC lidhur me bashkimin e tregjeve të energjisë*

### Seanca e pestë (V) e Bordit të ZRRE

Bordi i ZRRE-së ka mbajtur seancën e tij të pestë me radhe për vitin 2023, më 15.05.2023.

Në këtë seancë, Bordi ka shtyrë për mbledhjen e radhës kërkesën për dhënien e autorizimit për ndërtimin e parkut solar me kapacitet të instaluar prej 150MW për ndërmarrjen Solar Energy Group Evrope sh.p.k, në komunën e Gjakovës.

Në këtë seancë, Bordi ka aprovuar kërkesën për dhënie të licencës për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike të ndërmarrjes Eurosol&Energy LTD sh.p.k, si dhe ka refuzuar kërkesën e ndërmarrjes Bendcom Energy Point sh.p.k për shtyrje të autorizimit final V\_1211\_2019.

Po ashtu në këtë seancë Bordi ka pezulluar Rregullën Nr. 10/2017 për Skemat Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë. Ky vendim për pezullim të kësaj rregulle është

marrë si rrjedhojë e nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ Nr. 01.2023 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërithme, të nxjerr nga Ministria e Ekonomisë, ku mbështetja për energjinë e prodhuar nga BRE do të zhvillohet përmes skemave konkurruese.

### **Takim në mes Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe përfaqësuesve të kompanisë amerikane EnerSys për Sistemet e Ruajtjes së Energjisë në rajonin EMEA**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 16.05.2023, përmes Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë priti në takim z. Phil Arrowsmith, zv. president i kompanisë amerikane EnerSys për Sistemet e Ruajtjes së Energjisë në rajonin EMEA (Evropë, Lindje të Mesme dhe Afrikë).

Në këtë takim u diskutua rreth diversifikimit të gjenerimit të burimeve të ripërtërithme të energjisë dhe perspektivës së tranzicionit dhe qëndrueshmërisë në sektorin e energjisë, të nxitura nga iniciativat e shumta ndërkombëtare.



*Gjatë takimit mes Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe përfaqësuesve të kompanisë amerikane EnerSys*

### **Barazia gjinore si koncept dhe praktikë institucionale**

Me 13 qershor 2023, në ambientet e ZRRE-së është mbajtur trajnimi “Barazia gjinore si koncept dhe praktikë institucionale”, i përkrahur nga USAID përmes projektit ESA (Energy Sustainability Activity), implementuar nga Tetra Tech.

Ky trajnim është fokusuar në avancimin dhe njoftimin e mëtejshëm të stafit të ZRRE-së lidhur me çështjet e barazisë gjinore, diversitetit dhe përfshirjen në ndryshimet e synuara në lidhje me barazinë gjinore që është vazhdimësi e një serë trajnimesh të organizuara nga NARUC dhe USAID lidhur me këtë temë, ku kanë qenë pjesëmarrës edhe anëtarë të stafit të ZRRE-së. Në kuadër të këtij trajnimi, po ashtu u prezantua edhe rrugëtimi i ZRRE-së drejt barazisë gjinore si dhe plani i veprimit për arritjen e këtij qëllimi.



*13 qershor 2023, Pjesëmarrësit nga ZRRE, Tetra Tech dhe USAID për barazi gjinore*

### **Aktivitetet në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve në ZRRE**

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energi është përgjegjëse për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe të licencuarve, ndërmjet dy të licencuarve, si dhe në lidhje me qasjen e palës së tretë në sistemin e transmetimit, apo shpërndarjes së energjisë elektrike, energjisë termike apo gazit natyror, si dhe transmetimit, rrjedhave ndërkufitare të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

ZRRE gjatë periudhës janar - qershor 2022 ka regjistruar pesëdhjetë e një (51) ankesa të konsumatorëve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre kundër përgjigjeve të lëshuara nga ana e furnizuesit me energji elektrike, OSSH-së dhe NQ"Termokos", si dhe ka kthyer në rishqyrtim gjashtëdhjetë e tri (63) ankesa te Furnizuesi, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe NQ"Termokos". ZRRE përveç ankesave të regjistruara dhe të zgjidhura të konsumatorëve ka ofruar mbështetje edhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve, konsultimeve verbale përmes postës elektronike si dhe përmes bisedave telefonike për të gjithë konsumatorët e energjisë.

Gjatë periudhës janar - qershor 2022, ZRRE ka zgjidhur njëqind e një (101) ankesa të konsumatorëve, ku përfshihen edhe ankesat të cilat janë kthyer për rishqyrtim tek furnizuesi, operatori i sistemit të shpërndarjes dhe NQ"Termokos". Nga numri i përgjithshëm i ankesave të zgjidhura 72% janë aprovuar

ndërsa 19% janë refuzuar si të pabaza. Të gjitha ankesat e shqyrtuara nga ana e operatorëve, e të cilat janë proceduar te Rregullatori, janë rishqyrtuar edhe njëherë nga Rregullatori me qëllim të vërtetimit të zgjidhjes së plotë të ankesave sipas kërkesave të konsumatorëve, si dhe janë njoftuar konsumatorët përkatës. Në të gjitha rastet e rishqyrtuara konsumatorët janë pajtuar me zgjidhjet e ofruara.

Gjatë periudhës janar - qershor 2022 konsumatorët kanë parashtruar tri (3) ankesa tek Bordi i Rregullatorit kundër vendimeve të DMK-së. Nga tri (3) ankesat e regjistruara, Bordi i Rregullatorit i ka shqyrtuar të gjitha këto ankesa dhe i ka refuzuar si të pabaza. Furnizuesi KESCO ka parashtruar shtatë (7) ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të DMK-së të cilat Bordi i ka shqyrtuar dhe i ka refuzuar si të pabaza.

Gjithashtu Bordi i Rregullatorit ka shqyrtuar pesë (5) rekomandime të nxjerra nga DMK për ankesat e konsumatorëve komercial, me ç'rast Bordi ka aprovuar katër (4) nga rekomandimet e propozuara nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve kurse një rekomandim ka mbetur pa vendimmarrje.

### Licencimi i ndërmarrjeve të energjisë

Sa i përket licencimit të ndërmarrjeve të energjisë edhe gjatë këtij gjashtëmujori ka pasur kërkesa për licencim në aktivitete kryesisht për furnizim dhe tregtim të energjisë elektrike.

Gjatë këtij gjashtëmujori të parë të vitit 2023 Bordi ka aprovuar kërkesat e ndërmarrjeve si në vijim:

- **Future Energy Trading and Exchange Dynamics** - vazhdim i licencës për furnizim me energji elektrike
- **Danske Commodities Kosova SHPK** - furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike
- **Sharrcem** - furnizim me energji elektrike
- **Eurosol&Energy LTD SH.P.K.** - furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike.

Po ashtu ndërmarrjet kanë aplikuar për licencim dhe janë në proces deri në përmbyshjen e kushteve dhe dorëzimin e të gjithë dokumentacionit që kërkohet sipas legjislacionit në fuqi. Regjistri për ndërmarrjet e licencuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji është i publikuar në faqen elektronike të Rregullatorit.

### Aktivitetet ndërkombëtare dhe bashkëpunimi rajonal

#### Pjesëmarrja në Komunitetin e Energjisë

Zyra e Rregullatorit për Energji është pjesëmarrëse e vazhdueshme në aktivitetet e zhvilluara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (Energy Community Secretariat), ku pjesëmarrësit paraqesin të arriturat në sektor e poashtu në të njëjtën kohë marrin impute nga palët anëtare të Komunitetit të Energjisë, të cilat në masën më të madhe të mundshme i implementojmë në Kosovë.

Marrë parasysh situatën energjetike në vend dhe reagimin e palëve tjera ndaj rritjes së tarifave nga Zyra e Rregullatorit për Energji për konsumatorët që konsumojnë mbi 800kW, Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (Energy Community Regulatory Board – ECRB) ka përkrahur Rregullatorin e Kosovës me një shkresë të saj ku thuhet që “ECRB rikujton se autoritetet në Kosovë duhet të sigurojnë që Rregullatori i Energjisë të ushtroj detyrën në mënyrë të pavarur dhe pa ndonjë presion apo ndikim politik. Pavarësia e Rregullatorit të Energjisë është kërkesë ligjore, në përputhje me Traktatin e



Komunitetit të Energjisë. Vendosja e tarifave bllok u dëshmuar si një instrument efektiv për të nxitur reduktimin e kërkesës. Forumi vuri në dukje se masat mbështetëse të synuara për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë ende duhet të përmirësohen dhe të zbatohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Forum u bëri thirrje Palëve Kontraktuese që të heqin dorë nga masat deformuese të ndërhyrjes në treg duke zbatuar vetëm masat që janë në përputhje me *acquis* të Komunitetit të Energjisë dhe që stimulojnë uljen e kërkesës së konsumatorëve dhe sigurimin e mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm.

### Pjesëmarrja në Forumin e 28-të të Komunitetit të Energjisë

Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji z.Ymer Fejzullahu ka marrë pjesë në Forumin e 28-të të Komunitetit të Energjisë duke qenë edhe pjesë e një paneli ku u diskutua mbi masat rregullatore për sigurimin e energjisë së përballueshme për konsumatorët, si dhe shqyrtimin e hapave të nevojshëm për stimulimin e kursimeve në palët kontraktuese. Në këtë forum si tema debutuese kanë qenë: ndjekja e masave emergjente për të reduktuar kërkesën për energji, reformat e energjisë elektrike dhe elementet e rinj të projektimit, futjen e mekanizmit të rregullimit të kufirit të karbonit (CBAM), rruga drejt bashkimit të tregut të vetëm evropian (European Single Market Coupling), bashkëpunimi rajonal i OST-ve – bllok ndërtimi për sigurinë e furnizimit të Evropës dhe rritja e burimeve të ripërtëritshme – a janë gati sistemet dhe tregjet e energjisë?



*Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji gjatë prezantimit në forumin e 28 të KE*

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së z.Fejzullahu në këtë Forum ndau përvojën e Rregullatorit në menaxhimin e krizës energjetike, shqyrtimin e tarifave të energjisë elektrike dhe vendosjen e strukturës tarifore me blloqe.

### Vizitë Studimore lidhur me Certifikatat e Originës (Guarantee of Origin)

Përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji gjatë muajit maj 2023 kanë realizuar një vizitë studimore në Finlandë për Certifikata të Originës. Vizita është bërë në Grexel <https://grexel.com> dhe Autoritetin Rregullator të Energjisë së Finlandës <https://energiavirasto.fi/en/frontpage>. Nga këto dy institucione janë përfituar njohuri të reja, përvoja dhe praktika lidhur me proceset nëpër të cilat kanë kaluar këto institucione lidhur me Certifikatat e Originës.

Nga Autoriteti Rregullator i Energjisë së Finlandës është marrë përvoja se si bëhet promovimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Finlandë, si arrihet efikasiteti i energjisë dhe objektivat e dekarbonizimit, si lëshohen Certifikatat e Originës, kush është i kualifikuar për Certifikata të Originës, tregtimin e Certifikatave të Originës, rolin e Rregullatorit me qëllim të përshtatjes së objektivave të reja mbi përfshirjen e projekteve inovative për BRE, rezerva etj.



26.05.2023 Foto nga takimi ne Autoritetin Rregullator, nga a majta: Roland Magnusson, Martikainen Miikka, Taimi Emilia, Suni Mervi, Ripatti Pekka, Hysnije Rexhaj, Muharrem Gashi

Nga GREXEL – janë marrë informata mbi implementimin e platformës për Certifikata të Originës ku nga përfaqësues të tyre është prezantuar dhe demonstruar kjo platformë elektronike për regjistrat e Certifikatave të Originës.

Vlen të ceket se Grexel si ofrues i shërbimeve për Certifikata të Originës është emëruar përmes procesit të prokurimit nga Komuniteti i Energjisë të ofroj regjistrat e Certifikatave të Originës për tetë (8) vendet e Evropës Juglindore (përfshirë Moldavinë dhe Ukrainën).



25.05.2023 Foto nga takimi ne Grexel, nga a majta: Muharrem Gashi, Hysnije Rexhaj, Markus Klimscheffskij, Petrit Krasniqi

### Vendimet e Bordit të ZRRE-së, janar – qershor 2023

V\_1537\_2022 – Vendim për ankesën e konsumatorit Z.F;

V\_1664\_2023 – Aprovim i Taksave të Kycjes në Rjetin e Shpërndarjes (OSSH);

V\_1665\_2023 – Aprovim i Amandementimit të “Marrëveshjes për furnizim me ngrohje” e lidhur më 24.12.2014, nr. 252 në mes të KEK-Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. dhe NQ Termokos sh.a. dhe Aneks-Marrëveshja për caktimin e çmimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi;

V\_1666\_2023 – Aprovim i kërkesës së aplikuesit NTP “BLETA”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1667\_2023 – Aprovim i kërkesës së aplikuesit “SANTEFARM” sh.p.k. për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1668\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “Fatmir Mjeku” B.I., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1669\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “Kuvendi Komunal Prizren”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1670\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “Sami Morina”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1671\_2023 - Refuzim i ankesës së konsumatorit D.H nga komuna e Gjakovës;

V\_1672\_2023 - Refuzim i ankesës së konsumatorit J.B nga komuna e Prishtinës;

V\_1673 -2023 - Aprovohet si i bazuar kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin S.B, nga komuna e Prishtinës;

V\_1674\_2023 - Refuzim i kundërshtimit të KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin H.G nga komuna e Lipjanit , si i pabazuar;

V\_1675\_2023 - Refuzim i kundërshtimit të KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin D.H nga Komuna e Gjakovës, si i pa bazuar;

V\_1676\_2023 - Refuzim i kundërshtimit të KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin U.D nga Komuna e Prizrenit, si i pa bazuar;

V\_1677\_2023 - Refuzim i ankesës së konsumatorit B. P. M. G. SH.P.K nga komuna e Pejës;

V\_1678\_2023 – Aprovim i Bilancit Vjetor të Energjise Elektrike për vitin 2023;

V\_1679\_2023 – Aprovim i kërkesës së KOSTT sh.a per derogimet e dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit;

V\_1680\_2023- *Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut;*

V\_1681\_202 - *Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut;*

V\_1682\_2023 - *Refuzim i ankesës së konsumatorit Trepça sh.a ;*

V\_1683\_2023 - *Refuzim i ankesës së konsumatorit T.K “TEA” n.t.sh.*

V\_1684\_2023 - *I vendoset të Licencuarit për Furnizim me energji elektrike “KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY” J.S.C (“KESCo”) obligimi i shërbimit publik për furnizim të konsumatorëve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal;*

V\_1685\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit SH.F.M.U “MODEL”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1686\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “SEFA METAL”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1687\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit NTP “RAHVERA - AB”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1688\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “MOBILE DEKOR”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1689\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “GNTC GROUP” SH.A., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1690\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “FEIS - COM” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1691\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “MABEKO GROUP”SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1692\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “ALFA” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1693\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “FORTESA” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1694\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “CONCORDIA-Projekte Sociale”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1695\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “DELFIN”LTD, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1696\_2023 - *Aprovim i kërkesës së aplikuesit “N.Sh”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;*

V\_1697\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “P.D”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1698\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “E.E”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1699\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “Xh.H”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1700\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “E.O”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1701\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “N.R”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1702\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “S.B”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1703\_2023 – Aprovim i dokumentit “Bilanci vjetor i energjisë termike për vitin 2023” i Ndërmarrjes Publike “Termokos” sh.a;

V\_1704\_2023 - Aprovim i dokumentit “Bilanci vjetor i energjisë termike për vitin 2023” i ndërmarrjes “NGROHTORJA E QYTETIT sh.a”;

V\_1705\_2023-Aprovohen të Hyrat E Lejuara Maksimale që do të mblidhen nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – (KOSTT SH.A.), për Periudhën e Tretë Rregullative 2023-2027;

V\_1706\_2023 - Aprovohen të Hyrat E Lejuara Maksimale që do të mblidhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) KEDS SH.A., për Periudhën e Tretë Rregullative PRR3 2023-2027;

V\_1707\_2023 - Aprovohen të Hyrat E Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) për vitin 2023;

V\_1708\_2023- Aprovim i dokumentit “Plani pesë vjeçar Zhvillimor i Transmetimit për periudhën 2023-2027”;

V\_1709\_2023- Aprovim i dokumentit “Plani Zhvillimor dhjetë vjeçar i Shpërndarjes për periudhën 2023–2032”;

V\_1710\_2023 - Aprovim i dokumentit “ Plani Zhvillimor i Transmetimit për periudhën 2023–2032”;

V\_1711\_2023 - Aprovim i dokumentit “Plani Zhvillimor dhe Investues i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027”;

V\_1712\_2023 - Aprovohen Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit, Operimit të Sistemit dhe Operimit të Tregut, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT) duke filluar nga data 01 prill 2023 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor;

V\_1713\_2023 - Aprovohen Tarifat me Pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal, që do të mblidhen nga data 01 prill 2023 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor;

V\_1714\_2023 - Aprovohen Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (Tarifa SHSSH), që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);

V\_1715\_2023 - Refuzim i ankesës së konsumatorit XH.M nga komuna e Lipjanit;

V\_1716\_2023 – Ndryshim dhe plotësim i diapozitivit nën pikën II. të Vendimit Nr. V\_1680\_2023, të datës 23.03.2023;

V\_1717\_2023 - Ndryshim dhe plotësim i diapozitivit nën pikën II. të Vendimit Nr. V\_1681\_2023 të datës 23.03.2023;

V\_1718\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “SWISS MALL” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1719\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “GELI” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1720\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “Sabit Ademi”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V-1721\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “Esad Kamerrolli”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1722\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “Halim Baftiu”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1723\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “Adem Dabiqaj”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1724\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “I.K”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1725\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “BESIMI COMMERCE” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1726\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “S.R”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1727\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “SHARRI” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

V\_1728\_2023 - Aprovim i kërkesës së aplikuesit “L.B”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike;

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (ish ndërtesa e Fazitës),  
Kati 2, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620,  
E-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org), [web](http://www.ero-ks.org)  
[www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

Për konsumatorë:  
Tel: +381 (38) 247 615 lok. 116  
Email: [ankesa.dmk@ero-ks.org](mailto:ankesa.dmk@ero-ks.org)

Për çështje ligjore, licencim, BRE/autorizim:  
Tel: +381 (38) 247 615 lok. 114, 117, 118  
Email: [legal-licensing@ero-ks.org](mailto:legal-licensing@ero-ks.org)